



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 922, prot.
12

Tiranë, më 30.05.2025

V E N D I M

I KËSHILLIT DREJTUES

Nr. 17 datë 29/05/2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT “MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR NDËRTIMIN E BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË LIBRAZH

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sipas njoftimit nr.922 prot, datë 21.05.2025, pas shqyrtimit të materialit të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm, lidhur me relacionin për miratimin e draft Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Librazhd”, i përgatitur nga Drejtoria Juridike, mbështetur në Ligjin nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar, në VKM nr.198, datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave” i ndryshuar, si dhe në Statutin e EKB-së nr.10584/3 prot, dt. 02.10.2024;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Librazhd”, sipas draftit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Enkelejd Musabelliu

